

VENDIM
Nr.551, datë 28.12.2006

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT “SARANDA TV”
SUBJEKTIT: “SARANDA” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio televizivë”, të miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005 të KKRT-së, si dhe të zonave të frekuencave të lira të shpallura publikisht për periudhën nëntor-dhjetor 2006, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “Saranda TV” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Sarandës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ledi Bianku